



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

THYERJA E MITEVE TË ISIS-IT

SI TË KUNDËRVEPROHET NDAJ NARRATIVËS SË ISIS-IT NË INTERNET?
RASTI I SHTETEVE SHQIPFOLËSE

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

Autorë: Vesë Kelmendi dhe Rudinë Jakupi

Redaktor i brendshëm: Skënder Perteshi

Redaktore e jashtme: Garentina Kraja

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Të drejtat e pronësisë intelektuale mbrohen nga Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe Ligji Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër, pa lejen paraprake të botuesit. Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës. Ky projekt u mbështet nga Ambasada e Holandës në Kosovë. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë ato të Qendrës Kosovare për Siguri



Kingdom of the Netherlands

Ky projekt u mbështet nga Ambasada e Holandës në Kosovë. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë ato të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Ambasadës së Holandës në Kosovë.



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

THYERJA E MITEVE TË ISIS-IT

SI TË KUNDËRVEPROHET NDAJ NARRATIVËS SË ISIS-IT NË INTERNET?

RASTI I SHTETEVE SHQIPFOLËSE

TABLE OF CONTENT

1. HYRJJE.....	6
1.1. Metodologjia	8
2. SHPJEGIMI I KUNDËR-NARRATIVAVE.....	10
2.1 Çka është një kundër-narrativë.....	10
2.2. Pse nevojiten kundër-narrativat?	11
2.3. Kritikat ndaj kundër-narrativës	12
3. HARTËZIMI I OFRUESVETË KUNDËR-NARRATIVAVE NË KOSOVË	14
4. PASQYRA E NARRATIVËS SË ISIS-IT NË KOSOVË.....	19
4.1. Narrativat politike	19
4.2. Narrativat fetare:	23
4.3. Përdorimi i gjinisë si narrative:	30
5. REKOMANDIME	33
BIBLIOGRAFIA:.....	35
SHTOJCA A:	37
Fjalë kyçe:	37

GJETJET KYÇE:

- Raporti identifikon tri tema kryesore të që përshkojnë narrativën e ekstremizmit të dhunshëm të “Shtetit Islamik”, ashtu siç iu paraqiten audiencave në Kosovë dhe vendet e tjera të shqipfolëse. Ato janë: **marrëdhëniet e pushtetit politik, fetar dhe gjinor**
- Raporti konstaton se agjencitë qeveritare nuk kanë ushtruar një përpjekje të komunikimit strategjik për kundërveprimin ndaj ekstremizmit të dhunshëm, përkundër rolit qendror që i kishin caktuar në Strategji. Në Kosovë nuk është parë asnjë kundër-narrativë konsistente e sponsorizuar nga institucionet publike apo OJQ-të që vazhdimisht zbatojnë projekte të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në nivel lokal dhe qendror.
- Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), organi që rregullon çështjet fetare për besimtarët myslimanë në Kosovë, i mungon një platformë e bashkërenduar dhe në unison, e cila ofron kundër-narrativa kundër grupeve ekstremiste.
- Disa imamë të BIK-ut i kanë botuar në mënyrë të pavarur në platformat e tyre personale të mediave sociale predikimet dhe ligjëratat e tyre që mund të shërbejnë si kundër-narrativa.
- Një kundër-mesazh i efektshëm ndaj narrativës së ekstremizmit të dhunshëm të identifikuar përmes këtij hulumtimi, është narrativa që mund të sigurohet nga ish-luftëtarët e kthyer dhe të rraskapitur të “Shtetit Islamik” dhe anëtarët e familjeve të tyre.
- Raporti konstaton se platforma si Fol Tash, një portal kundër-narrativ i drejtuar nga një grup imamësh të bashkësisë, dhe Jo në Emrin Tim, një përpjekje në media sociale e Radios Evropa e Lirë, nuk janë përfillur në ueb faqet dhe chat-grupet (faqet për biseda) që vazhdojnë të propagandojnë dhe përkrahin “Shtetin Islamik”.
- Si pjesë e këtij studimi, hulumtuesit gjurmuan zakonet e simpatizantëve të ekstremizmit të dhunshëm në mediat sociale. Nga të 80 profilet dhe 100 faqet e grupeve ekstremiste të monitoruara në Facebook, asnjëri nuk jep “pëlqej”, “ndjek” ose “ndaj” për asnjë nga videot, tekstet ose fotot nga dy faqet e kundër-narrativave. Kjo sinjalizon se ndërkohë që këto platforma mund të veprojnë si masë parandaluese me publikun e gjerë, ato nuk kanë arritur të shtrihen tek përkrahësit e grupeve ekstremiste që vazhdojnë të gjenerojnë dhe shpërndajnë përmbajtje ekstremiste në mediat sociale.

1. HYRJE

Në thelb, aktet terroriste janë një formë e komunikimit politik. Veprimet e tilla synojnë të komunikojnë diçka përtej dhunës që shkaktojnë¹ dhe frikës që injektojnë në shoqëritë perëndimore. ISIS-i përdor disa prej akteve të kryera terroriste që të përforcojë narrativën e vet, për shembull ISIS-i ka marrë përgjegjësinë për disa akte terroriste për të cilat nuk u gjet asnjë lidhje mes sulmuesit dhe grupit terrorist.² Këto akte të dhunshme kanë kuptim dhe referencë; ato nuk duhet të merren si diçka e izoluar ose jashtë sferës së komunikimit, andaj, komunikimi strategjik duhet të jetë pjesë qendrore e çdo strategjie të kundërveprimit ndaj terrorizmit.

Me gjasë, përmes akteve terroriste kundër caqeve të zgjedhura me kujdes për të maksimizuar efektin e tyre, dhe me strategjinë e inskenuar në detaje të komunikimit që ushqen ciklin 24 orësh të lajmeve dhe komunikimin pa filtër me publikun, organizatat terroriste dhe përkrahësit e tyre e kanë krijuar tashmë një platformë të fortë të diskursit të tyre. Kjo platformë u drejtohet individëve dhe komuniteteve të cënueshme për qëllime të rekrutimit nga organizatat terroriste, dhe qëndron kundër diskursit liberal perëndimor ose tipareve që lidhen me atë sistem vlerash.

Kjo është korniza brenda së cilës ky raport do t'i përgjigjet pyetjes përse komunikimi strategjik, kryesisht aspekti i kundër-mesazheve të tij, është vendimtar për çdo strategji që synon të luftojë radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm dhe të minimizojë tërheqjen e organizatave terroriste mes grupeve të cënueshme.

Ndërkohë që territori i ISIS-it, dikur një zonë e gjerë që përfshinte Sirinë dhe Irakun, është kufizuar në disa kilometra katrorë në Siri, lufta e tij ka lëvizur drejt fushëbetesës së re në internet, veçanërisht në platformat e mediave sociale. I ashtuquajtur 'Shtet Islamik' e ka shfrytëzuar teknologjinë në mënyrë të pashembullt, duke pasur mundësinë që të arrijë tek kushdo që ka qasje në internet, dhe duke shpërndarë mesazhe me përmbajtje ushtarake, politike dhe fetare.³ Numri dhe madhësia e grupeve ekstremiste online që i përdorin rrjetet sociale që të ngacmojnë përdoruesit, të rekruto-

1 Pattwell.A. dhe Tyson.M et al. 'Terrorizmi si komunikim politik i dështuar' Gazeta Ndërkombëtare e Komunikimit, 2015. <https://ijoc.org/index.php/ijoc/article/viewFile/2247/1359>

2 **Nuk ka prova që e lidhin sulmin e Las Vegasit me ISIS-in. Pse e mori përgjegjësinë ky grup?** <https://www.pri.org/stories/2017-10-03/there-s-no-evidence-linking-las-vegas-attack-isis-so-why-did-group-claim-2017>

3 Zelin 2015

jnë anëtarë të rinj dhe të nxisin dhunë, po rritet me shpejtësi.⁴ Ndërkohë që platformat e [mediave sociale](#) po punojnë që ta luftojnë këtë fenomen (në vitin 2016 Twitter raportoi se kishte mbyllur 360,000 llogari të ISIS-it), zakonisht ato mbështeten së tepërmi në raportet e përdoruesve për identifikimin e këtyre llogarive.⁵ Kjo tregon se përpjekjet për frenimin e pranisë në internet të ISIS-it nuk po japin rezultate të shpejta, marrë parasysh edhe vetë natyrën e mediave sociale, çka e bën mjaft të vështirë që përmbajtja e tillë të hiqet në mënyrë efektive.

Simpatizantët dhe rekrutuesit e ISIS-it janë individë që jetojnë në të ashtuquajturin territor të “Shtetit Islamik” dhe njerëz që jetojnë në rajone të ndryshme të botës dhe që besojnë në utopinë e tij.⁶ Një nga pikat e forta të narrativës së ISIS-it është konsistenca e saj dhe aftësia e organizatës që krye-narrativën e vet ta përshtasë dhe zbatojë në kontekste të ndryshme, duke ushqyer ankesat lokale në shoqëritë demokratike, duke shfrytëzuar të drejtat e garantuara nga shtetet liberale, përfshirë lirinë e shoqërimit, të drejtën e lirisë së fjalës dhe të praktikës fetare.

Facebook-u, një platformë me përdorim të gjerë, ka qenë platforma parësore e mediave sociale e përdorur nga ISIS-i për t’u shtrirë në audiencën shqipfolëse në Ballkan dhe komunitetet e saj të diasporës. Në Kosovë, një vend me rreth 1.7 milion banorë, Facebook-un vlerësohet se e përdor gjysma e popullsisë, ose 970,000 individë, shumica e të cilëve janë nga mosha 18 deri në 24 vjeç.⁷ Për shembull, faqja ‘Islami është Hak’⁸ ka rreth 3698 ndjekës, 3693 pëlqime, 1000 shikime mesatare dhe 661 foto.⁹ Një tjetër faqe në Facebook, por e mbyllur tashmë, ‘Bota Islame’ kishte 2700 ndjekës dhe një numër të ngjashëm të pëlqimeve (2650).¹⁰

Nga viti 2017 në vazhdim, hulumtuesit nuk kanë vërejtur ndonjë ndryshim në narrativën e ISIS-it në gjuhën shqipe për audiencat në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, dhe pavarësisht nga humbja territoriale dhe rënia e liderëve të tyre, prania e grupit në media sociale ka mbetur e njëjtë. Në rastin e vendeve shqipfolëse, komponentët kryesorë të narrativës së ISIS-it mund të ndahen në dy kat-

4 <https://phys.org/news/2018-09-extremists-online-dangerous-content.html>

5 <https://phys.org/news/2018-09-extremists-online-dangerous-content.html>

6 Haldun Yalcunkaya, Tansel Ozyer, Bedi Celik dhe Sabah Kardas “Analiza e Rrjetit Social Twitter për përkrahësit turqisht-folës të Daesh-it”

7 330,000 të rinj 18-24 vjeç përdorin Facebook-un në Kosovë. Burimi: Hallakte, 2018 <https://www.facebook.com/Hallakate/photos/a.238589779544240/1566492466753958/?type=3&theater>

8 Kjo faqe është mbyllur tashmë nga Facebook.

9 Kelmendi.V. ‘Fushëbetejat e reja: Grupet e Ekstremistëve në Mediat Sociale’ 2017, fq.23

10 Kelmendi, 2017

egori kryesore: narrativat e nxitura në nivel ndërkombëtar dhe narrativat e nxitura në nivel lokal.¹¹ Narrativat e nxitura në nivel ndërkombëtar janë në të njëjtën linjë me propagandën e ISIS-it në mbarë botën - duke bërë propagandë kundër sistemeve demokratike sekulare dhe duke lëshuar paralajmërime për islamizimin në kërcënim.¹² Nga ana tjetër, narrativat e nxitura në nivel lokal janë të përqendruara kryesisht në adresimin e ankesave lokale, si besimi i ulët në institucione (duke i portretizuar institucionet shtetërore si të korruptuara), sulmimin e Bashkësisë Islame të Kosovës-BIK (duke pretenduar edhe se imamët lokalë të certifikuar nga BIK-u janë të korruptuar dhe nuk iu duhet besuar), dhe përdorimin e roleve dhe stereotipeve ekzistuese gjinore për të indoktrinuar gratë që të bashkohen me ISIS-in.

Rëndësia e kundër-narrativave u bë e dukshme në programet e ndërtimit të kapaciteteve për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (PEKDH). Pjesëmarrësit në programe të ndryshme identifikuan domosdoshmërinë e përcaktimit të temave të narrativës, si dhe rolin qendror të narrativës për përpjekjet e rekrutimit, si hapi i parë për sigurimin e kundër-mesazheve të efektshme. Në vendet shqipfolëse, grupet ekstremiste kanë qenë të suksesshme në krijimin e platformave online që injorojnë kufijtë shtetërorë dhe krijojnë një *gjuhë të lidhjes* mes njerëzve, përmes prodhimit të publikimeve, profileve, faqeve dhe lokacioneve të tyre.

Bazuar në analizën gjithëpërfshirëse të kërcënimeve të grupeve ekstremiste në mediat sociale, hulumtimi ynë trajton tri narrativa kryesore: (I) *narrativat politike (ideologjike dhe kundër institucioneve shtetërore)*, (II) *narrativat fetare*, (III) *narrativat e roleve gjinore*.

Raporti studion propagandën e bërë nga ISIS-i në gjuhën shqipe në përpjekje për të shënjestruar audiencat në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, të tre shtetet ku shqipja është gjuhë zyrtare.

1.1. METODOLOGJIA

Për qëllimet e këtij studimi, hulumtuesit e kanë bazuar këtë analizë kryesisht në teknikat e mbledhjes së të dhënave cilësore. Analiza e përmbajtjes, shqyrtimi i literaturës, hulumtimi/dokumentimi dhe intervistat janë kryer gjatë një periudhe prej gjashtë muajsh, nga korriku deri në dhjetor 2018.

11 Kraja.G. "Narrativa e Shtetit Islamik në Kosovë - e dekonstruktuar histori pas historie" QKSS, 2017. http://www.qkss.org/repository/docs/ISNinKosovo-eng_794656.pdf

12 Po aty.

Në përgatitjen e këtij raporti, metoda kryesore e përdorur e hulumtimit është analiza e përmbajtjes, përmes së cilës hulumtuesit i kanë studiuar nga afër dokumentet dhe artefaktet e komunikimit, si tekste, fotografi, audio dhe video, për të ekzaminuar modelet e komunikimit. Gjatë procesit u krijua një bazë të dhënash për profilet, faqet dhe grupet kryesore në mediat sociale që nxisin ideologjitë e ekstremistëve të dhunshëm, për të dalluar modele të caktuara që u ndihmuan hulumtuesve të nxjerrin konkluzionet kryesore të paraqitura në këtë raport.

U krye edhe shqyrtimi i literaturës për të krahasuar raste të ndryshme studimore, si një mënyrë për të identifikuar ngjashmëritë dhe për të identifikuar hendekët e mbetur në studimin e narrativës së ekstremizmit të dhunshëm. Përmes një krahasimi të rasteve studimore, hulumtuesit kanë arritur një kuptim më të gjerë të dallimeve në narrativat që organizatat terroriste përhapin në Evropën Perëndimore kundrejt atyre në rajonin e Ballkanit.

Në këtë raport, duke u mbështetur në literaturën dhe rastet studimore në Evropë dhe më gjerë, kemi vlerësuar edhe rëndësinë e komunikimit strategjik me komponentët e tij të kundër-mesazheve dhe kundër-narrativës, në kërkim të një modeli të përshtatshëm që do t'u ndihmonte palëve të ndryshme të interesit në Ballkan t'i bëhen pritë ndikimit të ISIS-it.

Si pjesë e procesit të analizës për këtë raport, hulumtuesit realizuan pesë intervista me përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) dhe studiues që punojnë në temën e ekstremizmit të dhunshëm.

2. SHPJEGIMI I KUNDËR-NARRATIVAVE

2.1 ÇKA ËSHTË NJË KUNDËR-NARRATIVË

Kur flitet për grupet dhe organizatat e ekstremistëve të dhunshëm, termi “kundër-narrativë” përdoret në lidhje me një gamë të gjerë aktiviteteve, shpesh të sponsorizuara nga qeveria ose të udhëhequra nga qeveria, të cilat synojnë diskreditimin e ideologjive dhe veprimeve të ekstremistëve të dhunshëm.

Në një raport të botuar nga Instituti për Dialog Strategjik, Briggs dhe Feve kanë krijuar një spektër të kundër-mesazheve për të ndihmuar në sqarimin e llojeve të ndryshme të aktiviteteve që mishëron ky përkufizim.¹³ Briggs dhe Feve sugjerojnë se ka tre lloje të kundër-narrativave: komunikimet strategjike të qeverisë, mesazhet alternative, dhe kundër-narrativat. Sipas tyre, komunikimi strategjik i qeverisë është fusha ku qeveria luan rolin më të natyrshëm dhe efektiv - qeveria duhet të hartojë një politikë të komunikimit strategjik që lidhet posaçërisht me sfidën e kundërveprimit ndaj këtyre narrativave në internet. Narrativat alternative përbëjnë narrativa të siguruara nga shoqëria civile dhe/ose qeveria, dhe qëllimi kryesor është të ofrohet një narrativë e ndryshme, një narrativë e re, në vend të angazhimit në të njëjtin nivel si grupet ekstremiste; dhe së fundi, kundër-narrativat trajtojnë drejtpërdrejt një narrativë ekstremiste, në përpjekje për të diskredituar mesazhet e ekstremistëve të dhunshëm. Ato synojnë individët, grupet dhe rjetet që kanë nisur rrugën e ekstremizmit, qofshin ata simpatizantë, përkrahës pasivë ose persona aktivë brenda lëvizjeve ekstremiste.

Në një artikull tjetër, Dimitriu nga Akademia e Mbrojtjes së Holandës shpjegon se një narrativë mund të përkufizohet si një ‘burim për aktorët politikë për të ndërtuar të kuptuarit e përbashkët që u jep formë perceptimeve, bindjeve dhe sjelljes së publikut’, dhe se kjo është korniza përmes së cilës arrihet kuptimi i përbashkët, që përfaqëson të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen, si dhe pengesën dhe fundin e dëshiruar.¹⁴

13 Rachel Briggs dhe Sebastian Feve, “Shqyrtimi i programeve të kundërveprimit ndaj narrativave të ekstremizmit të dhunshëm: Çka funksionon dhe cilat janë implikimet për qeverinë?” Instituti për Dialog Strategjik, (2013): 1, <https://www.counterextremism.org/resources/details/id/444/review-of-programs-to-counter-narratives-of-violentextremism-what-works-and-what-are-the-implications-for-government>

14 Dimitriu.G. & Beatrice.G. ‘Luftimi i Luftës në Atdhe: Narrativat strategjike, Reagueshmëria e Elitës dhe Misioni Holandez në Afganistan 2006-2010’, Analiza e Politikave të Jashtme 2016 12, 2-23 <https://www.ris.uu.nl/ws/files/20779691/2.full.pdf>

Marrë parasysh përkufizimet e gjera, për qëllimet e këtij raporti, hulumtuesit e QKSS-së e përcaktojnë kundër-narrativën si *‘një mesazh që ofron një alternativë pozitive ndaj propagandës ekstremiste, ose përndryshe synon t’i dekonstruktojë ose delegjitimojë narrativat ekstremiste.’*¹⁵

2.2. PSE NEVOJITEN KUNDËR-NARRATIVAT?

ISIS-i ka bërë përdorim të sofistikuar të platformave të mediave sociale për të prodhuar dhe shpërndarë mesazhet dhe narrativat e veta. Propaganda e vet mbështetet në mediat e veta, si Instituti Al-Furqan për Prodhimin e Medias, Fondacioni Al-Itisam Media, Qendra e Medias Alhayat, Fondacioni Ajnad Media; revistat e veta në internet që përfshijnë Dabiq, Lajme të Shtetit Islamik; dhe një numër forumesh të tjera online. Sipas *The Atlantic*, Al Hayat, ka prodhuar “qindra filma, duke filluar nga videot tre minutëshe të prerjeve të kokave, deri në reportazhe një orëshe që në mënyrë të habitshme kombinojnë elementet e shënimeve të udhëtimit, dokumentarëve historikë dhe pamjeve të mizorive”.

Komunikimi strategjik përmes videove të propagandës dhe mesazheve të shpeshta në media sociale, ka qenë mjeti më i fuqishëm i rekrutimit për ISIS-in. Një shembull ishte Arid Uka, përgjegjës për vrasjen e ushtarakëve amerikanë në Frankfurt, Gjermani. U raportua se Uken e kishte shtyrë drejt veprimit një video e rreme xhihadiste, ku përshkruhej përdhunimi i një vajze irakiane nga ushtarët amerikanë. Në fakt, për prodhimin e videos të postuar në mediat sociale ishin përdorur pamjet nga filmi artistik i Brian de Palma, *Redacted*.¹⁶ Me mjeshtëri ISIS-i ka krijuar mesazhe¹⁷ që kanë arritur miliona njerëz, dhe që përveç rekrutimit kanë lansuar një ideologji dhe një botëkuptim që sfidon demokracitë perëndimore liberale dhe laike në të cilat është infiltruar. Duke pasur parasysh këtë gjendje, sigurimi i ideve dhe narrativave alternative është thelbësor për luftimin e ndarjes së qartë “ne kundër tyre”, të cilën e kanë shfrytëzuar grupet e dhunshme ekstremiste.

Institucionet dhe shoqëria e gjerë, nga organizatat e shoqërisë civile tek aktivistët (online), këshillat rinorë, mësimdhënësit, psikologët dhe punonjësit socialë, duhet t’i sfidojnë pikëpamjet e ekstremistëve kudo dhe kurdo që munden. Sidoqoftë, një kundër-narrativa e efektshme varet nga koha:

15 Tuck. H. ‘Doracaku i kundër-narrativës’ 2016 https://www.isdglobal.org/wp-content/uploads/2016/06/Counter-narrative-Handbook_1.pdf f.65

16 <https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/Countering%20the%20Appeal%20of%20Extremism%20Online-ISR%20Report.pdf>

17 Tuck.H. ‘Doracaku i kundër-narrativës’ 2016, f.4

duhet të ndërmerret me shpejtësi dhe duhet t'i përgjigjet pretendimit të grupeve terroriste. Në shumicën e botimeve me përmbajtje ekstremiste në gjuhën shqipe, hulumtuesit zbuluan se narrativa përqendrohet në çështjet fetare. Pjesa më e madhe e përmbajtjes përqendrohet tek imamët radikalë, të burgosur pas akuzave për terrorizëm, dhe në interpretimin e shkrimeve të ndryshme fetare.¹⁸ Për të kundërvepruar ndaj këtyre pretendimeve, udhëheqësit fetarë duhet të japin një mesazh të koordinuar dhe të jenë në ballë të kundërshtimit të ekstremizmit fetar online dhe në përditshmëri.

Në Ballkanin Perëndimor - dhe në veçanti në Bosnjë dhe Kosovë, dy shtete që janë ende duke kapërcyer trashëgiminë e luftërave të viteve 1990 të shpërbërjes së Jugosllavisë - ekstremistët shfrytëzuan kujtimet e dhimbshme dhe ndarjet ekzistuese për ta thurur narrativën e tyre. Kështu, sigurimi i kundër-mesazheve përmes ofrimit të shpjegimeve të bazuara në fakte historike, sociologjike dhe politike, është çelësi për ta kundërshtuar me sukses narrativën e ekstremistëve.

2.3. KRITIKAT NDAJ KUNDËR-NARRATIVËS

Me përmbajtjen ekstremiste të disponueshme në internet, kundër-narrivat duhet t'u ofrojnë përdoruesve një kuptim më të plotë. Ndërkohë që ideja e kundër-narrativave është joshëse dhe premtese, ajo përballlet me një numër kritikash që tregojnë për problemet e mundshme.

Një raport i botuar nga Instituti Tony Blair për Ndryshim Global sugjeron se aktualisht kundër-narrivat nuk kanë zë mjaftueshëm të fortë në internet, pasi u mungon kohezioni, qëllimi dhe të kuptuarit e nuancave të botës online. Raporti konstatoi se ndërkohë që përmbajtja e ekstremistëve lidhet mirë me faqet e mëdha, si Kalamullah.com, Ummah.com dhe të tjera, kundër-narrivat nuk kishin marrëdhënie të ngjashme me faqet kryesore, çka sugjeron edhe mungesën e kohezionit në përpjekjet për kundërveprim. Për më tepër, ndërkohë që kundër-narrivat kërkojnë një periudhë më të gjatë kohore për t'u hartuar dhe përhapur, grupet terroriste si ISIS-i e ndryshojnë strategjinë e tyre të komunikimit, duke e bërë të vështirë për hulumtuesit dhe politikëbërësit që të përshtaten me shpejtësi me ndryshimin.

Përveç kësaj, kundër-narrivat përballen me sfidën e përhapjes. Për shembull, faqet kryesore myslimane për kundër-narrativa, si Sandala.org (faqja zyrtare e dijetarit të njohur ndërkombëtar islamik Hamza Yusuf, i cili shërbeu si këshilltar i Presidentit Xhorxh W. Bush) dhe Haqiqah.org, një përgjigje

¹⁸ Kelmendi.V. 2017

ndaj revistës të ISIS-it Dabiq, përfaqësojnë faqe me cilësi të lartë të kundër-narrativave, por u mungon përdorimi, me Sandala.org që ka marrë vetëm 25,503 lidhje në faqen e vet, dhe Haqiqah.org vetëm 110.

Përveç kësaj, faqet e sotshme të kundër-narrativave ofrojnë vetëm një përvojë pasive për përdoruesit, për dallim nga faqet ekstremiste që ofrojnë një hapësirë shumë më interaktive, duke i angazhuar shikuesit me përmbajtjen e vet, ndërkohë që faqet e qeverisë dhe faqet e tjera madhore të kundër-narrativave nuk e bëjnë këtë. Investimi në një faqe të moderuar mirë dhe interaktive, e cila lehtëson debatin ideologjik, do të ndihmonte në ndryshimin e balancës së ideve në internet. Ajo gjithashtu do të konkurronte drejtpërdrejtë me ueb faqe që përdorin të njëjtin format për të promovuar pikëpamjet ekstremiste.

Krijuesit e politikave vënë në pah edhe mungesën e një lidhjeje të qartë mes shikimit të përmbajtjes ekstremiste dhe angazhimit të vërtetë në ekstremizëm të dhunshëm. Megjithatë, kjo mund të argumentohet më tej, pasi organizatat terroriste si ISIS-i i kanë përdorur në masë të madhe internetin dhe mediat sociale për të përhapur mesazhet e tyre. Marrë parasysh numrin e publikimeve, është e qartë se ata e kanë shfrytëzuar internetin si mjetin kryesor të propagandës së tyre, dhe si mënyrën më relevante dhe me kosto efektive për t'u shtrirë në audiencën e shënjestruar.

Në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor (Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria), Strategjitë Kombëtare theksojnë nevojën e sigurimit të kundër-mesazheve. Sidoqoftë, deri më sot, në Ballkanin Perëndimor nuk është shënuar asnjë përpjekje sistematike qeveritare për sigurimin e kundër-mesazheve dhe kundër-narrativave.

Kundër-mesazhet, përveç përqendrimit në kontekstet lokale, duhet të ndërmarrin edhe një përpjekje rajonale për t'u përgjigjur natyrës së rekrutimit nga rekrutuesit kryesorë, të cilët në shtetet shqipfolëse i kanë tejkaluar me të vërtetë kufijtë, si në internet ashtu edhe në përditshmëri. Për shembull, siç shihet nga ndjekësit, pëlqimet dhe ndarjet në rrjetet e mediave sociale, Rexhep Memishi nga Maqedonia është shumë popullor në Kosovë dhe Shqipëri; Abdurrahim Balla nga Shqipëria është shumë popullor në Maqedoni dhe Shqipëri.¹⁹

19 Baza e të dhënave të mediave sociale të QKSS dhe Kelmendi. V. 2017

3. HARTËZIMI I OFRUESVE TË KUNDËR-NARRATIVAVE NË KOSOVË

Vitet e fundit, platformat e mediave sociale kanë qenë mjete kryesor për grupet terroriste si ISIS-i dhe të tjerë. Grupet terroriste si ISIS-i, kanë përdorur strategji të sofistikuar të komunikimit, duke përdorur propagandën në platformat e mediave sociale. Fillimisht, narrativat e tyre bazoheshin në përhapjen e mesazheve të “botës ideale” me jetën luksoze, dhe të pamjeve më të tmerrshme të vrasjeve.²⁰

Në kontekstin e vendeve të Ballkanit, platformat më të përdorura nga grupet ekstremiste shqipfolëse janë Facebook, YouTube dhe Telegram.²¹ Shumica e diskutimeve, mesazheve dhe rekrutimit ndodhin në platforma si Facebook, ku ata kanë krijuar grupe të mbyllura, ose në aplikacionin Telegram, ku ata kanë grupe të mbyllura gjithashtu. Për shembull, në Telegram ekziston një grup individësh që ndajnë materiale për xhihad, për të ashtuquajturin Shtet Islamik, dhe për ish luftëtarët nga vendet shqipfolëse. Kjo platformë quhet “Krenaria e Umetit” dhe tërheq vëmendje të madhe edhe në profilet e grupeve ekstremiste në Facebook.²²

Një nga arsytet pse narrativat e tyre kanë qenë të suksesshme, është për shkak se mediat ballkanike u kanë kushtuar vëmendje të madhe grupeve ekstremiste, sidomos ISIS-it.²³ I tillë ishte rasti i videos të përhapur nga një anëtar i ISIS-it²⁴, i cili i kërcënoi shqiptarët: “Pasha Allahun, ditë të zeza po vijnë për ju, keni me pas frikë me ec në rrugë. Keni me pas frikë me punu nëpër zyra. Keni me pa terror në shtëpitë tuaja. Kena me ju terrorizu në ëndrrat tuaja... Kena me ardh te ju me rripa eksplozivë,” paralajmëroi Aqifi në video nga fusha e betejës.²⁵ Kjo video ka qarkulluar online, madje edhe pas fshirjes së videos nga YouTube, dhe të gjitha mediat e kishin publikuar tashmë në ueb faqet e tyre. Për shembull, në Kanali Shtatë, raporti i videos arriti në më shumë se 250,000 individë në internet.²⁶

²⁰ Kelmendi.V. 2017

²¹ Raporti i Mediave Sociale, Vesa dhe Shpat

²² Baza e të dhënave të mediave sociale të QKSS dhe Kelmendi.V, 2017

²³ Shpend, Raport për Kundër-Narrativat, i pabotuar

²⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=1AmJ71iBSD0&t=34s>

²⁵ Kraja.G. 2017

²⁶ Kanali Shtatë, publikuar në qershor 2015. Qasur më 26/02/2019 <https://www.youtube.com/watch?v=1AmJ71iBSD0&t=34s>

- **Institucionet qeveritare**

Korniza e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm e miratuar nga Qeveria e Kosovës, e vendos theksin në 'parandalimin' e ekstremizmit të dhunshëm përmes identifikimit të narrativave të grupeve ekstremiste.²⁷ Që nga miratimi i Strategjisë, janë ndërmarrë aktivitete të shumta nga institucionet qendrore dhe lokale për të rritur vetëdijesimin kundër ekstremizmit të dhunshëm.²⁸ Përveç kësaj, shumica e aktiviteteve dhe hulumtimeve janë fokusuar në faktorët nxitës që kanë shtyrë qytetarë të Kosovës t'u bashkohen grupeve terroriste, si dhe sfidat e ri-integritimit të Luftëtarëve të Huaj (LH) të kthyer nga zona konflikti.

Sidoqoftë, agjencitë qeveritare nuk kanë ushtruar një përpjekje të komunikimit strategjik për kundërveprimin ndaj ekstremizmit të dhunshëm, përkundër rolit qendror që i kishin caktuar në Strategji. Hulumtuesit e QKSS-së nuk arritën të gjejnë asnjë kundër-narrativë konsistente nga institucionet apo OJQ-të që vazhdimisht zbatojnë projekte për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivelin lokal dhe në nivelin qendror në Kosovë.

- **Udhëheqësit fetarë**

Është e nevojshme të angazhohen bashkësitë fetare dhe udhëheqësit fetarë, veçanërisht në nivel lokal, në mënyrë që t'u jepet përgjigje efektive ekstremizmit të dhunshëm dhe materialeve të ekstremizmit të dhunshëm.²⁹ Udhëheqësit fetarë janë të rëndësishëm në këtë drejtim, pasi ata kanë potencial të ndikojnë në audiencat e shënjestruara, sidomos kur përmbajtja është përqendruar më shumë në argumente fetare ose ideologjike.³⁰ Për shembull, në përballjen me konceptet e '*xhihadit*', '*tekfirit*', '*kufarit*', '*shirkut*' dhe koncepte të tjera islame, është e rëndësishme të jepet interpretimi i këtyre nocioneve nga udhëheqësit fetarë që i kuptojnë dhe mund të ofrojnë kuptime të ndryshme alternative. Përveç kësaj, udhëheqësit fetarë mund të shërbejnë si modele për bashkëveprimin mes bashkësive të ndryshme fetare në Kosovë, siç janë komuniteti katolik, kisha ortodokse, bektashinjët dhe bashkësitë e tjera fetare.

27 Strategjia Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm që Çon në Terrorizëm, Qeveria e Kosovës, 2016 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf

28 Rudine Jakupi dhe Garentina Kraja "Shpjegimi i dallimit: Cenueshmëria dhe Reziliencia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë", tetor 2018 http://www.qkss.org/repository/docs/CTR_CaseStudy3_kosovo_ENG_574166.pdf

29 Nimer.M., Qasja alternative për transformimin e ekstremizmit të dhunshëm, Fondacioni Berghof, 2018 f. 8 https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Handbook/Dialogue_Chapters/dialogue13_Abu-Nimer_lead.pdf

30 Ziger.S. 'Minimi i narrativave ekstremiste në Afrikën Lindore - Udhëzues praktik', Hedayah, 2018. f. 20 <http://www.hedayahcenter.org/Admin/Content/File-18201819229.pdf>

Sidoqoftë, kur analizohet Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), vërehet se mungon një kanal i bashkërenduar dhe në unison i ngritur nga BIK-u për të siguruar kundër-narrativa kundër grupeve ekstremiste. Është vërejtur se disa nga imamë të BIK-ut i kanë botuar ligjëratat dhe diskutimet në mënyrë të pavarur në platformat e tyre personale të mediave sociale. Këta imamë janë shumë popullorë dhe gëzojnë vëmendje të madhe edhe nga komunitetet. I tillë është rasti i Elvis Naçit (një imam shumë popullor në vendet shqipfolëse), i cili vazhdimisht poston dhe ndan ligjëratat, lajme, opinione të tij mbi fenë, tolerancën, diversitetin dhe paqen. Profili i tij në Facebook ka më shumë se 600,000 ndjekës nga të gjitha vendet shqipfolëse.³¹

Për më tepër, ka pasur përpjekje nga imamët lokalë që të flasin për këto çështje në televizione lokale dhe në ligjëratat e tyre të botuara në platformat e tyre personale të mediave sociale.³² Ndërkohë që ekzistojnë raste individuale të imamëve të ndryshëm që prodhojnë kundër-narrativa (megjithëse nuk fokusohen në mënyrë specifike kundër ekstremizmit të dhunshëm), mungon një sistem i unifikuar nga selia e BIK-ut për prodhimin e kundër-narrativave.

- **Ish luftëtarët dhe anëtarët e familjeve**

Kundër-mesazhet më të efektshme të identifikuara gjatë këtij hulumtimi janë ato të artikuluar nga ish luftëtarët e kthyer dhe anëtarët e familjeve të tyre.³³ Individët që kanë marrë pjesë në ekstremizëm dhe terrorizëm të dhunshëm dhe që e kanë ndezur grupin, kanë potencial të jenë lajmëtarë të fuqishëm për të parandaluar hyrjen e të tjerëve.³⁴ Një raport nga Neumann (2015) sugjeron se dezertorët nga Daesh mund të japin katër mesazhe kyçe që janë të zbatueshme edhe në kontekstin e vendeve shqipfolëse: 1) theksimi i luftës së brendshme dhe ndasive brenda grupit; 2) zbulimi i brutalitetit kundër myslimanëve; 3) ekspozimi i korrupsionit dhe praktikave jo-islame të grupit; dhe 4) zbulimi i cilësisë së dobët të jetës.^{35 36}

Përkundër rreziqeve, stigmatizimit dhe presionit nga shoqëria në Kosovë, ka raste kur ish-luftëtarët e kthyer kanë ndarë histori nga udhëtimet e tyre në Siri dhe Irak, siç është rasti i ish-luftëtarit të

31 <https://www.facebook.com/ElvisNaci/>

32 Shih psh Enis Rama, emisioni Ekstremizmi, <https://www.youtube.com/watch?v=YGDgTzFE3VE>

33 Dialogu ekstrem nga ISD është një platformë që boton dhe ndan histori të vërteta nga ish luftëtarët dhe të tjerët të ndikuar nga ekstremizmi i dhunshëm. Kjo është një nismë e zbatuar në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar, në shkollat dhe hapësira të tjera me të rinjtë. <https://extremedialogue.org/stories>

34 Zieger.S. 2018

35 Neumann 2015

36 Zieger.S. 2018

kthyer A.B.,³⁷ i cili iu bashkua organizatës terroriste. Pas kthimit të tij, ai iu bëri thirrje të rinjve të Kosovës që të qëndrojnë larg konfliktit në Siri.³⁸ Ai foli publikisht për udhëtimin e tij në zonat e konfliktit dhe për çka kishte parë atje: “Kisha imagjinuar se kjo opozitë ndaj Assadit nuk kishte njerëz me prejardhje kriminale në radhët e saj,” thotë ai. Kurse ai mendonte, sipas fjalëve të tij, “se do të ketë vetëm njerëz me vullnet të mirë që duan të ndihmojnë popullatën.”³⁹ Rrëfimi i tij bie ndesh me çka trumbetohet nga anëtarë të tjerë të ISIS-it nga Kosova, të cilët u referohen luftëtarëve të opozitës dhe atyre të grupeve terroriste si “luanë”.

- **Burimet mediatike**

Gjatë punës hulumtuese, hulumtuesit e QKSS-së identifikuan dy burime mediatike, siç janë FOL TASH dhe Radio Evropa e Lirë, të cilat në mënyrë specifike prodhojnë kundër-narrativa përmes platformave të tyre në mediat sociale. QKSS-ja ka krijuar një bazë të dhënash (2015-2018) të grupeve ekstremiste dhe profileve individuale në mediat sociale, dhe kemi krahasuar si ndikojnë këto kundër-narrativa në faqet dhe profilet ekstremiste.

FOL TASH - është një platformë e themeluar nga imamë, profesorë të studimeve islame dhe akademikë të studimeve islame. Objektivi kryesor i kësaj platforme lidhet me tendencat e reja të ekstremizmit në Kosovë, për ta mbrojtur islamin nga “rreziku i elementëve radikalë dhe ekstremistë, dhe ideologjitë e huaja”, dhe për t’u ofruar besimtarëve burime alternative dhe të ndryshme mbi mënyrën si predikohet islami. Për më tepër, në ueb faqja e Fol Tash fokusohet në shkëmbimin e informacionit rreth imamëve që i kanë shërbyer kauzës shqiptare gjatë historisë.⁴⁰ Platforma ofron informacion mbi imamët si Ali Kraja, të cilët kanë qenë aleatë të ngushtë me figurat katolike shqiptare si Gjergj Fishta.⁴¹ Kjo është veçanërisht e rëndësishme, sepse shikuesit dhe lexuesit mund të shohin se historikisht ka pasur një kulturë të dialogut ndërfetar mes bashkësive të ndryshme fetare në Kosovë, të cilat përkundër dallimeve mes tyre i kanë shërbyer një kauze të përbashkët. Më tej, në ueb faqe jepen edhe informacione për kontributin e imamëve dhe predikuesve myslimanë në krijimin e alfabetit të shqipes.

Kjo platformë prodhon kundër-narrativa që lidhen më shumë me keqinterpretimin e islamit, dhe është e fokusuar në mënyrë specifike në narrativat terroriste, si ajo e ISIS-it, dhe raportimet e

37 Emrat e vërtetë dhe inicialet janë koduar

38 Albert Berisha: <https://www.bbc.com/news/stories-43173173>

39 Po aty.

40 Qasja në platformën FOL TASH: <http://www.foltash.com/kategoria/personalitet/>

41 <http://www.foltash.com/kategoria/personalitet/>

lajmeve në lidhje me këto grupe.⁴² Për shembull, platforma boton periodikisht artikuj që ofrojnë kundërshtime të propagandës së ISIS-it - një nga artikujt e tyre analizon se kush ishte në të vërtetë 'Kalif Bagdadi'.⁴³

Jo në Emrin Tim - është një platformë digjitale e REL, qëllimi i së cilës është të rrisë vetëdijesimin mbi të rinjtë dhe komunitetin, veçanërisht për të informuar publikun për grupet terroriste dhe çështje të tjera të dhunshme. Kjo platformë shërben për dialog për të gjitha format e radikalizmit (përfshirë ekstremizmin fetar dhe ekstremizmin etnik-politik), dhe i inkurajon të gjithë lexuesit dhe përdoruesit të zhvillojnë biseda publike në lidhje me përmbajtjen e tyre.⁴⁴ Faqja është më e fokusuar në prodhimin e videove dhe botimin e hulumtimeve të reja që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm. Edhe pse duhet të mbulojë të gjitha format e ekstremizmit, kjo platformë është më e fokusuar në kundër-narrativën e myslimanëve dhe tolerancën fetare në Kosovë. Është e rëndësishme të theksohet se kjo platformë ka më shumë se 30,000 ndjekës në faqen e tyre në Facebook.⁴⁵

DOKUFEST - Festivali Ndërkombëtar i Dokumentarit dhe Filmit të Shkurtër, është festivali më i madh i filmit në Kosovë. Ky festival organizohet çdo vit që nga viti 2002, në komunën e Prizrenit. Festivali është i njohur për atmosferën e gjallë, entuziazmin që e kaplon qytetin dhe popullatën e tij, si dhe për numrin e lartë prej 150 vullnetarësh që punojnë për këtë ngjarje.⁴⁶ Në vitin 2018, Dokufest filloi të zbatojë aktivitete për të rinjtë, të cilat synojnë të rrisin vetëdijen në nivel lokal. Filma të ndryshëm paraqiten në një hapësirë ku të rinjtë mund të diskutojnë në lidhje me temat e filmit. Filmat kategorizohen në tema për aktet e dhunës, diversitetin, të drejtat e njeriut dhe historike, sepse qëllimi është të ofrohen kundër-mesazhe përmes kinematografisë. Gjithashtu, Dokufest ka inkurajuar të rinjtë në komunat e cënueshme nga ekstremizmi i dhunshëm që të prodhojnë dokumentarë rreth historive të suksesit të individëve në komunitetin e tyre.

Gjatë analizimit të faqeve të grupeve ekstremiste, u pa qartë se këto platforma, si Fol Tash dhe Jo në Emrin Tim, nuk kanë arritur të stimulojnë kuriozitetin në profilet dhe faqet që ende promovojnë propagandën dhe rekrutimin për të ashtuquajturin ISIS. Hulumtuesit e QKSS-së i kanë identifikuar këto profile në bazë të faqeve që mbështesin të ashtuquajturin Shtet Islamik dhe që promovojnë materiale kundër institucioneve shtetërore të Kosovës.

42 <http://www.foltash.com/mbeshitetesit-e-isis-it-ende-paraqesin-rrezik-per-kosoven/>

43 <https://www.foltash.com/e-kujt-i-shebeu-i-vetequajturi-kalife-bagdadi/>

44 <https://www.facebook.com/joneemrintim/>

45 <https://www.facebook.com/joneemrintim/>

46 <http://dokufest.com/info/about-dokufest/>

Disa nga platformat e mediave sociale, siç është Facebook-u, na lejojnë të shohim faqet që “pëlqejnë” ose “ndjekin” këta individë, dhe duke analizuar 80 profile dhe 100 faqe të grupeve ekstremistë është e qartë se ata nuk ndjekin asnjë nga këto dy platforma. Gjithashtu, nga 80 profile të analizuar mund të shohim se ka 0 video, tekste apo lajme “të ndara” nga platforma si Fol Tash ose Jo në Emrin Tim. Kjo tregon se këto platforma nuk kanë arritur të shtrihen tek grupet që ende shpërndajnë përmbajtje ekstremiste në mediat sociale dhe materiale të tjera në komunitetin ku jetojnë.

4. PASQYRA E NARRATIVËS SË ISIS-IT NË KOSOVË

Në kontekstin e Ballkanit vërehet lidhja dhe bashkëpunimi mes grupeve ekstremiste, sidomos përgjatë vijave etnike të shqiptarëve në Maqedoni dhe Kosovë. Janë disa raste/profile të identifikuar nga këto shtete rajonale, që vazhdojnë të bëjnë propagandë për Shtetin Islamik, dhe të cilët janë kthyer nga Siria kohët e fundit, por qëndrojnë të fshehur për momentin.

Bazuar në analizën tonë, narrativat e përdorura nga grupet terroriste dhe përkrahësit e ISIS-it në rastin e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë, mund të ndahen në tri tema kryesore:

1. **Narrativat politike**
2. **Narrativat fetare**
3. **Përdorimi i roleve gjinore si narrative**

4.1. NARRATIVAT POLITIKE

Në përputhje me propagandën e ISIS-it në mbarë botën, përkrahësit e ISIS-it në Kosovë promovojnë në mënyrë aktive narrativat që janë të përqendruara kryesisht kundër vendeve/shoqërive perëndimore, shtet-ndërtimit dhe bashkësive të tjera fetare të pranishme në Kosovë. Këto narrativa politike janë zhvilluar për të bërë propagandë kundër Qeverisë së Kosovës, OJQ-ve, komunave dhe kryetarëve të komunave, anëtarëve të kuvendit, dhe në veçanti kundër Bashkësisë Islame të Kosovës.

Ata përpiqen t'i bindin ndjekësit e tyre që t'i braktisin institucionet e zgjedhura në mënyrë demokratike, dhe këtë e bëjnë duke shfrytëzuar besimin tashmë të ulët që qytetarët e Kosovës kanë në institucionet e lartpërmendura.⁴⁷ Më tej, ata u kërkojnë ndjekësve të tyre që të mos marrin pjesë në zgjedhje apo ndonjë proces që kontribuon në ndërtimin e një shoqërie demokratike në Kosovë.

Në vitin 2016, i ashtuquajtur Shteti Islamik publikoi përmes Al-Hayat, një video propagandistike prej 20 minutash, kryesisht duke u fokusuar në luftërat e Ballkanit gjatë viteve '90. Video përpiqet të krijojë një lidhje mes luftës në Bosnjë dhe një islamit 'të sulmuar'⁴⁸ nga të krishterët dhe të pafetë.⁴⁹ Video vazhdon më tej me diktaturën në Shqipëri, tregon pamjet e shkatërrimit të minareve, dhe përpiqet t'i portretizojë myslimanët si të pambrojtur dhe nën kërcënimin e forcave laike dhe demokratike.⁵⁰ Megjithatë, video injoron plotësisht rastin e luftës dhe ndërhyrjen e udhëhequr nga NATO në Kosovë, një vend me shumicën e popullsisë myslimane.

Grupet e ekstremistëve të dhunshëm në Kosovë flasin në mënyrë aktive kundër vetë idesë së demokracisë, siç shihet në fotot e mëposhtme. Posteri pretendon se përmes zgjedhjeve dhe votimeve të organizuara në një sistem demokratik, vendosen ligje që janë kundër Allahut, çka e bën demokracinë "shirk" dhe "kufër".⁵¹ Narrativa shkon aq larg sa të pohojë se demokracia është fe, pasi njerëzit "adhurojnë" sistemin dhe i binden ligjeve të tij, në vend të ligjeve të Allahut. Sipas një imami të intervistuar nga hulumtuesit e QKSS-së, "kuptimi i tyre është sipërfaqësor, ata komunikojnë emocionalisht dhe jo me arsye, dhe u mungon në masë të madhe mënyra e duhur e argumentimit". Ai beson se retorika e tyre është tërheqëse për disa individë, sepse është shumë e thjeshtë: 'Ndoshta, për këtë arsye kësaj retorikë i mungon shija, logjika dhe këmbëngulja, dhe për rrjedhojë vërehet niveli i paarrtshëm i komunikimit. Sipas meje, ky është një koncept i islamit që është shumë i përshtatshëm me injorancën dhe euforinë'.⁵²

Grupet e ekstremistëve të dhunshëm pohojnë edhe se të votosh ose të zgjidhësh në një sistem demokratik është "kufar", duke u bërë thirrje ndjekësve të tjerë që të mos votojnë dhe të mos marrin

47 KSB 2018 http://www.qkss.org/repository/docs/barometri2018-eng2_477654.pdf

48 ISIS-i vazhdimisht ka pretenduar se islami dhe myslimanët në të gjithë botën janë nën sulm nga Perëndimi, SHBA dhe të krishterët. Ata u bëjnë thirrje të gjithë myslimanëve (Umetit) që të bashkohen dhe ta kapërcejnë këtë rrezik.

49 Kraja.G 'Dekonstruktimi i narrativës së ISIS-it në Kosovë', QKSS, 2017. f. 21 http://www.qkss.org/repository/docs/ISNinKosovo-eng_794656.pdf

50 Po aty, f. 35

51 Për këto koncepte, ju lutemi shihni Perteshi.S. 'Udhëzuesi i Gazetarëve - Ekstremizmi i dhunshëm: Përkufizimi dhe Terminologjia', 2018. http://www.qkss.org/repository/docs/Guideline_669605_187367.pdf

52 Intervistë me imamin lokal, janar 2019

pjesë në zgjedhje. Ata u kërkojnë ndjekësve të tyre të mobilizohen kundër Demokracisë dhe sistemeve demokratike, pasi sipas tyre, demokracia lejon që njerëzit të zgjidhen dhe të krijojnë ligje. Ata pretendojnë se në sistemet demokratike janë njerëzit që i gjykojnë të tjerët, dhe jo Zoti, duke e bërë pra mëkat pjesëmarrjen në çfarëdo procesi në një shtet demokratik. Për më tepër, ata pretendojnë se është e ndaluar të bashkëpunosh me një shtet laik, pasi sistemet demokratike nuk gjykojnë në bazë të ligjit të Sheriatit, dhe çdo institucion që ka të drejtën për të gjykuar (duke iu referuar gjykatave dhe sistemit të drejtësisë) është 'duke konkurruar' me Zotin.⁵³

Përkrahësit e ISIS-it i përdorin shpesh ankesat lokale, dhe përpiqen t'i paraqesin udhëheqësit lokalë në Kosovë si kukulla përëndimore që i diskriminojnë dhe shtypin myslimanët në Kosovë. Ata përdorin kontekstin aktual socio-politik dhe ekonomik të Kosovës për t'i krijuar këto narrativa, dhe pretendojnë se udhëheqësit e Kosovës janë politikanë të korruptuar të cilëve nuk u duhet zënë besë. Këto grupe shkojnë aq larg sa të pretendojnë se myslimanët e Kosovës janë të përndjekur nga shteti.⁵⁴




Foto 1: Propaganda kundër sistemeve demokratike

53 Propaganda në internet, e përhapur kryesisht përmes Facebook-ut. Referojuni fotos 1

54 Kraja, 2017, f. 30

Kundër-mesazhi alternativ ndaj narrativave politike të përdorura nga ISIS-i:

- ☞ Çështja e votimit dhe angazhimit me institucionet shtetërore laike shpesh trajtohet sipas konceptit islamik «të përfitimit më të madh neto». Kjo nënkupton që mes dy të këqijave («të ligave») duhet të zgjedhësh të keqen («të ligën») më të vogël, dhe mes dy të mirave, duhet të zgjedhësh më të mirën.⁵⁵ Kur të jepet mundësia e votimit në një shtet laik, dhe përmes votës mund të përmirësohen jetët e myslimanëve, atëherë votimi në një shtet laik shpesh konsiderohet si e keqja më e vogël, dhe individit duhet të angazhohet në të.
- ☞ Siç tregojnë dëshmitë, dhe duke qenë se ISIS-i është i gatshëm t'i sulmojë dhe shkatërrojë xhamitë vetëm për shkak se imamët dhe/ose besimtarët e asaj xhamie të veçantë nuk pajtohen me ISIS-in, myslimanëve dhe besimtarëve myslimanë u lejohej të bashkëpunojnë me çdo institucion laik shtetëror, duke përfshirë institucionet e sigurisë, për të parandaluar veprime të tilla që mund të ndër marrë ISIS-i, ose ndonjë grup apo individ tjetër. Bashkëpunimi me strukturat laike të sigurisë shtetërore, përsëri konsiderohet si “e liga” më e vogël. Në fakt, në rrethana të tilla, bashkëpunimi me institucionet laike shtetërore inkurajohet.
- ☞ Pjesëmarrja në zgjedhje është shenjë dalluese e demokracisë, dhe është në interes të individit dhe komunitetit të gjerë, kurse injorimi ose bojkotimi i një procesi të tillë e shtyn shoqërinë në zgrip të regjimeve autoritare, nga të cilët do të vuajë edhe bashkësia fetare (myslimane).⁵⁶
- ☞ Shteti laik është një realitet në të cilin njerëzit e të gjitha besimeve jetojnë dhe punojnë së bashku. Përmirësimi i kushteve sociale nuk ndodh në vakum, izolim, apo me konfrontime (të dhunshme). Islami na mëson se të gjithë duhet të punojmë së bashku, për të mirën e përbashkët të të gjithë shoqërisë.⁵⁷
- ☞ Përmendja e luftës në Kosovë, dhe e ndërhyrjes së udhëhequr nga NATO në Kosovë për të ndaluar krimet masive kundër civilëve shqiptarë të Kosovës, është çelësi për të minimizuar propagandën kundër vendeve përfundimtare në territoret shqiptare.
- ☞ Duhet më shumë përqendrim në të përbashkëtat mes komuniteteve të ndryshme, me shembuj konkretë (myslimanë, katolikë, çifutë etj.), sesa në dallimet ndërmjet komuniteteve.⁵⁸ Udhëheqësit fetarë mund të përdorin shumë shembuj historikë, si p.sh. pajtimi i gjakmarrjes, lëvizja për pavarësi, e cila arriti t'i bashkojë njerëzit nga të gjitha përkatësitë fetare në Kosovë.

55 Kursani.Sh. “Kundër-Narrativat”, 2015, i papublikuar

56 Intervistë me imamin, janar 2019

57 Po aty.

58 <https://www.youtube.com/watch?v=SubqELgVHb8&feature=youtu.be>

4.2. NARRATIVAT FETARE:

Disa imamë konsiderojnë se propaganda ekstremiste e ISIS-it dhe e simpatizuesve të tyre në vendet shqipfolëse është përhapur gjerësisht përmes rrjeteve të mediave sociale, dhe kryesisht nga burime anonime, pasi këta persona përdorin pseudonime ose emra konspirativë. Ata madje mund të njihen me emër dhe mbiemër në qarqe të caktuara, por nuk kyçen me emrat e tyre të vërtetë, por me emra të ndryshëm.⁵⁹ Kjo mund të përbëjë një sfidë ndaj sigurimit të kundër-narrativave efektive, pasi ata mund të jenë të përhapur gjerësisht nëpër platformat e mediave sociale, dhe veprojnë nëpër kanale të ndryshme duke përdorur profile të rreme. Sipas këtij imami, referencat e tyre [ekstremistëve] nuk janë pjesë e botës akademike, ose kur citojnë dijetarë të islamit, grupet ekstremiste e ndryshojnë kontekstin në varësi të situatës së tyre.⁶⁰

Gjatë analizës së përmbajtjes së profileve dhe faqeve individuale, shihet se grupet ekstremiste janë kryesisht të përqendruara në diskutimet e lidhura me fenë. Në bazë të këtyre profileve, faqeve dhe grupeve të mbyllura, vërehet se ata interpretojnë dhe diskutojnë koncepte të ndryshme si: xihadi, toka e shenjtë, konceptin e dëshmorëve dhe të pafeve ose kufarëve. Në raportin “Kalifati Virtual”: të kuptuarit e Strategjisë së Propagandës së Shtetit Islamik” analizohen gjashtë tema të brendit të Shtetit Islamik, të cilat janë të ngjashme me narrativat e grupeve ekstremiste në vendet e Ballkanit. Propaganda e të ashtuquajturit “Shteti Islamik” fillon dhe mbaron me brutalitet, duke përdorur narrativa dhe tema të tilla si viktimizimi, lufta, mëshira, përkatësia dhe utopizmi.⁶¹

1. Narrativa mbi xihadin - sipas ISIS-it⁶² - Organizatat terroriste, si Al-Kaida dhe ISIS-i, vazhdimisht e kanë keqpërdorur fjalën “xihad”. Grupet terroriste si ISIS-i, e kanë interpretuar vetëm në kuptimin e ngushtë të luftës dhe të përdorimit të dhunës nga myslimanët kundër të pafeve dhe të tjerëve që nuk ndajnë të njëjtën ideologji me ato grupe.⁶³ Përmes fjalës “xihad”, grupet e dhunshme ekstremiste kanë tentuar të legjitimojnë vrasjen e civilëve që nuk u nënshtrohen urdhrave të grupeve terroriste. Një nga qëllimet e tyre kryesore është të propagandojnë për të ashtuquajturin “Shtet Islamik”, dhe të rekrutojnë individë në komunitetet e tyre.⁶⁴

59 Intervistë me imamin, janar 2019

60 Intervistë me imamin, janar 2019

61 “Kalifati Virtual: të kuptuarit e Strategjisë së Propagandës së Shtetit Islamik” file:///C:/Users/KCSS9/Downloads/the-virtual-caliphate-understanding-islamic-states-propaganda-strategy.pdf

62 [http://www.qkss.org/repository/docs/Udhezues_per_gazetar_797776_\(1\)_302167.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Udhezues_per_gazetar_797776_(1)_302167.pdf)

63 Po aty.

64 Po aty.

Kundër-mesazhet/Alternativat ndaj Xhihadit⁶⁵

- ☞ Sipas imanit lokal të intervistuar nga hulumtuesit e QKSS-së, 'xhihadit' është një koncept i promovuar nga islami, por që përfshin shumë më tepër se vetëm luftë të armatosur. Çdo përpjekje dhe përkushtim për të mirën e përgjithshme është xhihad sipas islamit. Kufizimi i xhihadit vetëm në luftën e armatosur është i gabuar, ashtu siç është e gabuar të lihet xhihadit në duart e atyre që nuk kanë legjitimitetin, dijen ose dëshirën për ta bërë siç duhet. Kurse dëmi më i madh ndaj xhihadit dhe islamit në përgjithësi është keqpërdorimi i tij për qëllime vrastare dhe shkatërrimtare.⁶⁶
- ☞ Më tej, sipas këtij udhëheqësi fetar, mënyra më e mirë për të kundërvepruar ndaj këtyre narrativave është debati i mirëfilltë, i qetë dhe me argument (online ose në hapësira të hapura në komunitete), dhe që mund të drejtohet vetëm nga imamët dhe dijetarët islamë, njohësit e vërtetë të islamit, kur marrim parasysh se ata që e përqafojnë këtë mënyrë të të kuptuarit të islamit janë të barrikaduar, dhe mbajnë qëndrime "mbrojtëse", të cilat mund të jenë armiqësore në raste të caktuara.⁶⁷
- ☞ Xhihadit është interpretuar në disa mënyra. Nga njëra anë është "xhihadit i madh", që nënkupton vetëpërmbytjen nga kryerja e veprimeve imorale që konsiderohen shkelje kundër ligjit hyjnor dhe, në përgjithësi, përpjekjen për t'u bërë person më i mirë. Kurse "xhihadit i vogël" i referohet mbrojtjes dhe përhapjes aktive të besimit përmes forcës së armatosur. Ky kuptim i veçantë i "luftës së shenjtë" dhe të dhunshme është mbizotërues në Kuran. Pjesa e parë e këtij pretendimi të ISIS-it (duke iu referuar kalimit nëpër fazën e xhihadit të dhunshëm) duket se është frymëzuar nga një hadith që i atribuohet Muhametit, i cili thotë: "Dije se Parajsa është nën hijet e shpatave"⁶⁸

65 Bazuar kryesisht në intervistën me një imam në Mitrovicë, janar 2019

66 Po aty.

67 Po aty.

68 Sfidimi i narrativës së "Shtetit Islamik" <https://icct.nl/wp-content/uploads/2015/06/ICCT-Schmid-Challenging-the-Narrative-of-Islamic-State-June2015.pdf>

2. Ideja e Kalifatit - Sipas ideologjisë së ISIS-it, ideja e Kalifatit përshkruhet në këtë mënyrë: Përmes propagandës së vet, ISIS-i ka bindur individë dhe grupe nga e gjithë bota se ata kanë krijuar kalifatin utopik të njohur si “Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut”. Sipas ISIS-it, “Shteti i Ri” është vendi ku të gjithë myslimanët mund të jetojnë të lirë dhe të pakufizuar në ushtrimin e fesë së tyre, dhe i inkurajoi të gjithë të bashkoheshin me këtë koncept dhe ta njihnin udhëheqësin e vet si “kalif” de-facto të myslimanëve.⁶⁹

Për shembull, në këtë pasazh nga shpallja e Kalifatit, Abu Bakr shtjellon temat e turpit dhe poshtërimit që shumë myslimanë kanë përjetuar në jetën e tyre:

“Ngrini kokat lart. Tash e keni një shtet dhe një kalifat që e rikthen nderin tuaj, fuqinë tuaj, të drejtat tuaja dhe sovranitetin tuaj. Shteti formon një lidhje vëllazërie mes arabëve dhe jo-arabëve, të bardhëve dhe të zinjve, lindorëve dhe perëndimorëve. Kalifati bashkon kaukazanët, indianët, kinezët, shamët, irakenët, jemënitët, egjiptianët, afrikano veriorët, amerikanët, francezët, gjermanët dhe australianët... Ata janë të gjithë në të njëjtën llogore, duke mbrojtur njëri tjetrin, duke ruajtur njëri tjetrin, dhe duke sakrifikuar për njëri tjetrin. Gjaku i tyre përziehet nën një flamur [me] një qëllim dhe në një kamp... kryejnë hixhra nga darul-kufr në darullIslam. Ka shtëpi këtu për ju dhe për familjet tuaja. Mund të jesh kontribues i madh në çlirimin e Mekës, Medinës dhe El-Kudsit. A nuk do të donit të arrinit në Ditën e Gjykimit me këto vepra madhështore... Një jetë në xhihad është e pamundur pa i mbledhur sendet tuaja dhe pa shkuar në kalifat.”⁷⁰

Në vendet shqipfolëse, strategjia e ISIS-it është kryesisht e përqendruar në islam, duke nxitur dhunën⁷¹, dhe duke promovuar utopinë e të ashtuquajturit **“Kalifat dhe të bashkimit të myslimanëve nën një udhëheqës të vetëm (Kalifi)”**, ku me argumentet e tyre mbi xhihadin justifikojnë veprimet dhe propagandën e tyre në emër të islamit, për të arritur qëllimet e tyre politike dhe ideologjike. Për më tepër, në diskutimet e tyre të fundit, thuhet se duhet të rivendoset “nderi i myslimanëve” dhe Kalifati i të ashtuquajturit Shtet Islamik.⁷² Ata kanë krijuar figura heroike nga luftëtarët e huaj nga Kosova, për shembull, kur u vra Lavdrim Muhaxheri në Siri ai u lëndua si hero nga profilet e grupeve ekstremiste në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.⁷³

69 Perteshi.S. “Raporti i Udhëzuesit të Gazetarëve”, QKSS, 2018 http://www.qkss.org/repository/docs/Guideline_669605_187367.pdf

70 Sfidimi i narrativës së “Shtetit Islamik” <https://icct.nl/wp-content/uploads/2015/06/ICCT-Schmid-Challenging-the-Narrative-of-Islamic-State-June2015.pdf>

71 Baza e të dhënave e QKSS-së për mediat sociale

72 Faqe në Facebook e përkrahësve të ISIS-it dhe përmbajtje ekstremiste

73 Kelmendi.V. 2017

Siç shihet në foton e mëposhtme, ku është shkruar “Shteti Islam do të Qëndroj”, ndërkohë që ISIS-i ka humbur territorin, simpatizuesit e ISIS-it vazhdojnë ta mbështesin idenë e kalifatit dhe ‘ta mbrojtjes së umetit mysliman nga kufarët’.



Foto 2. Foto e marrë nga profili në Facebook i një simpatizanti të ISIS-it

Kundër-mesazhet/Alternativat ndaj idesë së Kalifatit:

ISIS-i ka përvetësuar një variant të popullarizuar të flamurit standard të xhihadit të përdorur që nga viti 1980, një flamur i zi me një rreth të bardhë në mes që përmban vulën e Profetit me fjalët “I dërguari i Zotit Muhamet”. Udhëheqësi i organizatës e ka shpallur veten kalif (që do të thotë “pasardhës”, dhe duhej të ishte zëvendës-regjent i Muhametit). Titulli “kalif” është përdorur për sundimtarët islamikë që mbikëqyrin çështjet fetare dhe politike të një bashkësie islame, ndërkohë që “kalifatit” i referohet territorit ose shtetit të sunduar nga kalifi.⁷⁴ Fillimisht, kalifi ishte një udhëheqës politiko-fetar, i cili vepronte edhe si komandant suprem ushtarak (amir al-mu’minin). Sidoqoftë, ky funksion i dyfishtë u shua pas mbretërimit të katër kalifëve të para. Kalifatit të fundit Islamik (osman) i erdhi fundi në vitin 1924, kur Mustafa Kemal Atatürk, në fushatën e tij për një Turqi laike dhe moderne, e shfuqizoi institucionin e kryesuar nga kalifi i fundit, Abdylmexhidi i dytë. Pas një harrese 90 vjeçare, Abu Bakr Al-Baghdadi u vetë-deklarua “kalif” i kalifatit botëror më 29 qershor 2014. Sipas një dijetari islam, Rusydi ‘Alyan (në librin e tij *Al-Islam wa al-Khilafah*, 1996), një “kalif” duhet të ketë “njohuri të thella të ligjit të Sheriatit” (që kalifi i ri ndoshta i ka), dhe “të jetë i drejtë, i virtytshëm, dinjitoz, i pjekur dhe i arsyeshëm”, që Abu Bakr al-Baghdadi tashmë ka reguar se nuk është.⁷⁵

I ashtuquajtur ‘Kalifat’ i bazuar në logjikën e ISIS-it, kishte pak lidhje me burimet apo parimet islame, dhe siç ishte raportuar ata kontrabandonin edhe pornografi.⁷⁶

Ka pasur raporte për rreth 75 qytetarë të Kosovës që kanë vdekur në zonën e konfliktit. Aktualisht, rreth 63 individë mbahen në paraburgim, dy janë në arrest shtëpiak, 83 janë nën proces hetimi.⁷⁷ Për më tepër, ligji aktual në Kosovë ua ndalon qytetarëve të Kosovës që t’u bashkohen konflikteve të huaja, duke paraparë dënim me burg deri në 15 vjet.⁷⁸

Nga një këndvështrim thjesht teologjik, në shtator 2014 një grup prej 152 dijetarëve kryesues islamë - rreth tre muaj pas shpalljes së Kalifatit - i shkroi një letër Abu Bakr al-Bagdadit, duke përshkruar çka ata e konsideronin si gabim dhe shkëlqej të ligjeve islame dhe ndërkombëtare të kryer nga udhëheqësit dhe përkrahësit e ISIS-it. Këtu është një mostër e 24 kundërshtimeve të tyre:⁷⁹

74 Sfidimi i narrativës së “Shtetit Islamik” <https://icct.nl/wp-content/uploads/2015/06/ICCT-Schmid-Challenging-the-Narrative-of-Islamic-State-June2015.pdf>

75 Po aty

76 Shpend, Raport për Kundër-Narrativat, i pabotuar

77 Jakupi.R. dhe Garentina.K’Shpjegimi i dallimit: Cenueshmëria dhe Rezilienca ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë, QKSS 2018, http://www.qkss.org/repository/docs/CTR_CaseStudy3_kosovo_ENG_574166.pdf

78 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10763>

79 Sfidimi i narrativës së “Shtetit Islamik” <https://icct.nl/wp-content/uploads/2015/06/ICCT-Schmid-Challenging-the-Narrative-of-Islamic-State-June2015.pdf>

“Në islam është e ndaluar që njerëzit të detyrohen të konvertohen; Në islam është e ndaluar që grave t’u mohohen të drejtat e tyre; Në islam është e ndaluar të vriten të pafajshmit; Rivendosja e skllavërisë është e ndaluar në islam; Në islam është e ndaluar të torturohen njerëzit; Në islam është e ndaluar që të deklarohet një kalifat pa konsensus nga të gjithë myslimanët; Besnikëria ndaj kombit është e lejuar në islam; Pas vdekjes së Profetit... Islami nuk kërkon nga askush të emigrojë diku; Në islam xhihadi është luftë mbrojtëse.”⁸⁰

3. Narrativat e të pafeve/kufarve/kafirve: Përkrahësit e ISIS-it dhe ekstremistët e dhunshëm i konsiderojnë si ‘të pafe’ ose ‘tradhtarë të islamit’ shumicën dërrmuese të imamëve vendorë, vetë bashkësinë dhe të gjithëve që mendojnë ndryshe prej tyre⁸¹. Nga ana tjetër, ata i justifikojnë vrasjet e njerëzve duke thënë se vendet dhe njerëzit që e luftojnë ISIS-in janë ‘kafirë’ ose ‘kryqtarë’ që shkatërruan islam. Ata përdorin narrativa të ashpra kundër imamëve lokalë, sektit shi’it dhe Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK). Për shembull, në videon e lëshuar më 5 qershor 2018, nga **‘Minaret e Shqipërisë’** me titullin ‘Gjendja e Umetit Sot’, tregohet një histori e shkurtër e luftës në Siri, civilë dhe luftëtarë të huaj që janë pjesë e ISIS-it.⁸² Në këtë video, narrativa e tyre thekson konceptet e të pafeve, kufarëve, kafirëve, dhe atyre që përpiqen të luftojnë ideologjinë e ISIS-it.⁸³ Videoja është hequr nga Facebook-u dhe YouTube, por hulumtuesit e QKSS-së e transkriptuan tekstin gjatë kohës kur u lëshua:

“E kur myslimanet bëjnë thirrje për xhihad → Akuza është gati (Khawarixh)

Vallë vetëmbrojtja qenka Kawarixhizëm

A mos vallë vetëmbrojtja e Ligjit të Allahut dhe ngritja e Khilafetit qenka prapambetje?

Kthimi i nderit të myslimanëve qenka ekstremizëm dhe terrorizëm?”⁸⁴

80 Po aty.

81 Kursani, Raporti i pabotuar 2015

82 Baza e të dhënave e QKSS-së për mediat sociale 2018

83 Po aty.

84 Po aty.

Kundër-mesazhet/Alternativat ndaj narrativës për të pafetë:

- Adresimi i “të vërtetës” në “besimtarët e vërtetë”: Përkrahësit dhe simpatizantët e ISIS-it duhet të ballafaqohen me narrativa alternative islame, të cilat ofrojnë interpretime të hapura dhe racionale të islamit, pasi ato kanë ekzistuar për shekuj me radhë, jo vetëm në historinë e pasur mesjetare të qytetërimeve islamike, por deri në shekullin e 19-të dhe përtej.⁸⁵Në këtë mënyrë, myslimanët mund të jenë në gjendje ta sfidojnë diskursin e “të vërtetës kundrejt të pavërtetës” të përkrahësve të ISIS-it, dhe të ndihmojnë për të theksuar interpretimet islame me më shumë nuanca. E vërteta është një koncept i pakapshëm; shumica e feve pretendojnë të jenë në zotërim të së vërtetës përfundimtare; por “të vërtetat” e tyre shpesh janë në kundërshtim me njëra tjetrën, madje shumë prej tyre janë kontradiktore brenda të njëjtës fe. Një gjë është e sigurt: “e vërteta” nuk përcaktohet duke frikësuar dhe duke ua prerë kokat atyre që japin argumente që nuk mund të kundërshtohen me sukses me anë të logjikës, arsyes dhe testimit empirik. Ndërkohë që ISIS-i mund të vrasë njerëz dhe të shkatërrojë monumentet e trashëgimisë kulturore të njerëzimit, ai nuk mund të vrasë idetë e shoqëruara me to.⁸⁶
- Ndërkohë që ISIS-i pretendon se lufton Perëndimin, duke i konsideruar si “kufarë”, nuk përpiqet fare ta fshehë faktin se luftëtarët e huaj i paguan me dollarë amerikanë që mbajnë shenjën e “Në Zot Besojmë”, por ISIS-i e di dhe e kupton se amerikanët flasin për një interpretim tjetër të Perëndisë nga ai që beson ISIS-i. Ata përdorin edhe termat hamvi “kufar”, armët “kufar”, veshjet “kufar”, mediat sociale “kufar” etj. Edhe kalifi i vetëshpallur mban një orë “kufar” që është e dukshme në videon e postuar nga ISIS-i të fjalimit të tij të parë publik, kur ai shpalli krijimin e “Shtetit Islamik”.⁸⁷
- Një tjetër hipokrizi që ISIS-i nuk ka si ta fshehë, është fakti se të hyrat e tyre kryesore vijnë nga kontrabanda e naftës. ISIS-i u shet naftë nën çmimet e tregut regjimeve që ata i konsiderojnë “kufar”, madje shkon deri aty sa i shet naftë dhe gaz regjimit sirian (Assadit), të cilin pretendojnë se po e luftojnë, një kauzë për të cilën rekrutojnë luftëtarë të huaj.⁸⁸

85 Sfidimi i narrativës së “Shtetit Islamik” <https://icct.nl/wp-content/uploads/2015/06/ICCT-Schmid-Challenging-the-Narrative-of-Islamic-State-June2015.pdf>

86 Sfidimi i narrativës së “Shtetit Islamik” <https://icct.nl/wp-content/uploads/2015/06/ICCT-Schmid-Challenging-the-Narrative-of-Islamic-State-June2015.pdf>

87 Shpend Kursani, Raporti për Kundër-Narrativat, i pabotuar

88 Po aty

4.3. PËRDORIMI I GJINISË SI NARRATIVË:

Trendi më i fundit i grupeve ekstremiste në rrjetet sociale tregon se është përqendruar shumë vëmendje në rolin e grave në organizatat terroriste. Në profilet e tyre, faqet, grupet e mbyllura dhe në Telegram, narrativat e tyre janë të përqendruara në forcimin e rolit të grave në Shtetin Islamik. Kur u krijua i ashtuquajti Shtet Islamik, gratë kishin role dytësore, si kujdestare dhe ofruese të kujdesit,⁸⁹ kurse tani vëmendja po zhvendoset tek gratë si mbrojtës të “Shtetit Islamik”. Sipas kësaj narrative, tani gratë duhet të marrin pjesë aktive në krijimin e Kalifatit, dhe në mënyrë të ngjashme me burrat duhet të synojnë të rekrutojnë gra të tjera dhe të kryejnë sulme vetëvrasëse.

Në Facebook është hapur një faqe më e re, e quajtur “Motrat e Kalifatit/Hilafetit”, ose është ri-aktivizuar “Mbrojtja e Umetit”, ku përkrahësit e ISIS-it përdorin argumente dhe materiale të ndryshme që kanë për qëllim rekrutimin e vajzave të reja si përkrahëse të organizatave terroriste.⁹⁰ Në Facebook, një grup reklamon një kanal të Telegramit që ofron udhëzime të sigurisë operative, si shmangia e përdorimit të emrave të tyre të vërtetë ose e identifikimit kur regjistrohen për një Apple ID ose aplikacion të Android-it. Në mënyrë më eksplicite, postimi deklaron:

“Motrat tona të dashura, ju lutemi ta ndani dhe ta ndiqni këtë kanal (në Telegram). Kufari nuk do që ne të jemi të sigurt, por ne e kemi detyrë ta mbrojmë Umetin tonë dhe Shtetin tonë Islamik. Këto aplikacione të shkarkuara nga ky kanal sigurojnë që mos ta jepni informacionin tuaj personal për apple ose android, duke ju mbajtur më të sigurt”⁹¹

Gratë ishin pjesë e strategjisë së rekrutimit të ISIS-it në Kosovë.⁹² Transkriptet e gjykatave ofrojnë një vështrim mbi një dimensionin të kuptuar pak, mbi mënyrën si ndikon perspektiva gjinore në rekrutimin e ISIS-it, duke dhënë një pasqyrë të mesazheve dhe bisedave nga dhe mes grave dhe burrave, duke treguar narrativën e ndjekur prej tyre, që e kanë përhapur edhe në komunitetet e tyre. Gratë e të pandehurve duket se i përkrahin, madje i motivojnë bashkëshortët e tyre që t’u bashkohen konflikteve dhe organizatave terroriste në Siri. Për shembull, njëra shkruan: *‘Kjo kërkon sakrificë, jo kushdo urdhëron bekimin e Allahut, përdore, sepse nuk di nëse do ta kesh përsëri këtë shans.*

⁸⁹ Jakupi dhe Kelmendit ‘Gratë në Ekstremizëm të Dhunshëm: Rasti i Kosovës’, QKSS 2017

⁹⁰ Kelmendi V., ‘Jo thjesht viktima: Gratë në Terrorizëm nga Ballkani Perëndimor’, f. 25, George Washington University 2019 https://extremism.gwu.edu/sites/g/files/zaxdzs2191/f/Perspectives%20on%20the%20Future%20of%20Women%2C%20Gender%20and%20Violent%20Extremism.pdf?fbclid=IwAR29VYWw42qTxV8v1S1iXdPgaCGWuUvVlF3_7DLnh7Twz8tN-33NwT79xtw

⁹¹ Po aty.

⁹² Aktakuza PPS nr. 111/2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, 7 maj 2015

Më fal për këto fjalë, por dua që ne të fitojmë parajsën;⁹³ një tjetër shkruan: “Është vërtetë e vështirë për mua, por jam krenare për ty... Allahu na ka nderuar me xhihadin tënd, dhe do të përpiqem ta ruaj këtë nder me krenari dhe përkushtim... mos harro se jam krenare për burrin tim, muxhahidin tim.”⁹⁴

Për më tepër, shumë prej grave duket se e shpërndajnë të njëjtën propagandë të ISIS-it edhe mes anëtarëve të tjerë të familjes. Siç shihet nga transkriptet e gjykatës, njëra prej grave përpiqet t’i paralajmërojë të tjerët duke pretenduar se *“shteti laik ka me ia marrë fëmijët një myslimani që nuk i çon në shkollë. Ne duhet të shkojmë atje ku do të gjykohesh nga ligji i Sheriatit”⁹⁵*



Foto 3: Profili i një gruaje që mbështet faqet e ekstremistëve në Facebook

93 Aktakuza PPS nr. 111/2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, 7 maj 2015

94 Aktakuza PPS nr. 25/2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, 7 maj 2015

95 Aktakuza PPS nr. 25/2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, 7 maj 2015

Kundër-mesazhet/Alternativat ndaj narrativës për rolet gjinore:

- Ndërkohë që jetonin në territoret e ISIS-it, nëse iu vriteshin burrat, gratë detyroheshin të martoheshin me burra që nuk i njihnin më parë. Dëshirat dhe interesat e tyre nuk merreshin parasysh, sepse ata thjesht shërbenin si skllevër të burrave.
- Ndërkohë që jetonin në territoret e mbajtura nga ISIS-i, gratë janë përdhunuar sistematikisht nga luftëtarët e ISIS-it. Ka shumë shembuj të ndryshëm të kësaj, duke filluar nga gratë jazide tek gratë nga Kosova, të cilat janë detyruar të martohen pa pëlqimin e tyre.
- Në islam, gratë duhen kursyer nga çdo lloj aktiviteti ushtarak dhe nga pjesëmarrja në fushën e betejës. Më e shumta që mund të kontribuojnë gratë në xhihadin e armatosur është që të bëhen pjesë e operacioneve logjistike, ose të shërbejnë si infermiere/mjeke, por nuk duhet kurrë të marrin pjesë të drejtpërdrejtë në luftime.⁹⁶
- Ndërkohë që dihet se grupet ekstremiste i bënin të ndihen si 'motra' duke u dhënë ndjenjën e përkatësisë, është e rëndësishme të ofrohet një alternativë ndaj kësaj ndjenje. Për shembull, organizata të ndryshme duhet që në mënyrë aktive t'i nxisin gratë të formojnë komunitete 'simotrash' në vendet ku jetojnë, duke u anëtarësuar në klube të ndryshme, duke ndjekur kurse, në internet, etj., jo domosdoshmërisht duke iu bashkuar grupeve/ideologjive të ekstremistëve.
- Shumë gra nga vendet shqipfolëse, të cilat u bashkuan me organizatat terroriste, kanë mbetur në zonat e konfliktit në Siri/Irak, kryesisht në kampet e refugjatëve. Siguria dhe sigurimi e tyre mbeten të panjohura, pasi është mjaft e vështirë të arrihet tek to, ose të ketë komunikim të drejtpërdrejtë. Andaj, për të dhënë një shpjegim të gjendjes së tyre aktuale, kemi nevojë për zërat e anëtarëve të familjeve të tyre. Për shembull, vëllai i një gruaje që ndodhet në kamp të refugjatëve pohon se motra e tij nuk ka kushte të mira jetese, është shpesh pa ushqim dhe pa higjienën e duhur.⁹⁷

96 Intervistë me imamin, dhjetor 2018

97 Intervistë me J.K. 2018

5. REKOMANDIME

Për qeverinë

- Çdo kundër-mesazh ose narrativë që i drejtohet publikut duhet të jepet në kohën e duhur, pas propagandës së fundit ekstremiste, dhe duhet të përditësohet me propagandën e fundit të ofruar nga grupet ekstremiste.
- Qeveria e Kosovës duhet të lansojë një strategji të kundër-mesazheve. Për më tepër, zyrtarët e qeverisë duhet të jenë konsistentë dhe të mos japin narrative të ndryshme në të njëjtën kohë. Këto mesazhe duhet të shmangin krijimin e stigmatizimit dhe izolimit të mëtejshëm, dhe duhet të drejtohen në atë mënyrë që krijon një ndjenjë të komunitetit dhe përfshirjes.

Për organizatat e Shoqërisë Civile dhe Bashkësinë Islame të Kosovës (BIK):

- Bashkësia Islame e Kosovës duhet të krijojë një platformë të unifikuar dhe të bashkërenduar, ku të prodhohen kundër-mesazhe përmes videove, diskutimeve publike, fushatave online dhe promovimit të punës së tyre në komunitet.
- Bashkësia Islame e Kosovës, Shqipëria dhe Maqedonia, duhet të krijojnë një strategji kohezive të komunikimit që ndalon përdorimin e gjuhës së urrejtjes ose nxitjen e diskriminimit në çdo formë nga imamët e tyre.
- Organizatat e shoqërisë civile, duke përfshirë organizatat lokale, duhet të krijojnë platforma të edukimit digjital, ku të rinjtë mund të ekspozohen ndaj ideve dhe alternativave të ndryshme dhe të formojnë mendimin e tyre kritik mbi çështje si demokracia, feja etj. Këto platforma duhet të krijohen në nivel lokal në bashkëpunim me komunitat dhe komunitetin e donatorëve.
- Mediat duhet të bashkohet për të krijuar një kod sjelljeje për raportimin mbi terrorizmin dhe storjet që lidhen me terrorizmin.

Për hartuesit e politikave dhe hulumtuesit - Si të zhvillohet një kundër-narrativë?

Sipas Hedayah, botimi më i fundit për kundër-narrativat, këshillohet që politikëbërësit dhe hulumtuesit të ndjekin nëntë hapa kur dizajnojnë një kundër-narrativ efektive.⁹⁸

1. Për të kuptuar dhe vlerësuar faktorët relevantë shtytës dhe tërheqës
2. Identifikoni audiencën e synuar kryesore që dëshironi të adresoni
3. Identifikoni qartë aspektet eksplicite dhe implicite të narrativës së ekstremizmit të dhunshëm ndaj së cilës kundërveprohet (tregoni qartë çfarë është narrativa e përdorur nga grupet ekstremiste)
4. Vendosni një qëllim dhe objektiv të kundër-narrativës
5. Përcaktoni se kush do ta ofrojë narrativën (kush është Lajmësi)
6. Zhvilloni përmbajtjen e mesazhit
7. Identifikoni mediumet ku do të përhapet mesazhi (kundër-narrativa)
8. Zhvilloni një strategji të përhapjes
9. Së fundmi, vlerësoni ndikimin e kundër-narrativës suaj

⁹⁸ Zieger.S. 'Minimi i narrativave ekstremiste në Afrikën Lindore - Udhëzues praktik', Hedayah, 2018.

BIBLIOGRAFIA:

“Kalifati Virtual: të kuptuarit e Strategjisë së Propagandës së Shtetit Islamik” <file:///C:/Users/KCSS9/Downloads/the-virtual-caliphate-understanding-islamic-states-propaganda-strategy.pdf>

Sfidimi i narrativës së “Shtetit Islamik” <https://icct.nl/wp-content/uploads/2015/06/ICCT-Schmid-Challenging-the-Narrative-of-the-Islamic-State-June2015.pdf>

Dimitriu.G. & Beatrice.G. ‘Luftimi i Luftës në Atdhe: Narrativat strategjike, Reagueshmëria e Elitës dhe Misioni Holandez në Afganistan 2006-2010’, Analiza e Politikave të Jashtme, 2016 12, 2-23

Platforma FOL TASH: <http://www.foltash.com/kategoria/personalitet/>

Haldun Yalcunkaya, Tansel Ozyer, Bedi Celik dhe Sabah Kardas “Analiza e Rrjetit Social Twitter për përkrahësit turqisht-folës të Daesh-it”

<http://dokufest.com/info/about-dokufest/>

<http://www.foltash.com/kategoria/personalitet/>

<http://www.foltash.com/mbeshtetesit-e-isis-it-ende-paraqesin-rrezik-per-kosoven/>

<https://phys.org/news/2018-09-extremists-online-dangerous-content.html>

<https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/Countering%20the%20Appeal%20of%20Extremism%20Online-ISD%20Report.pdf>

<https://www.facebook.com/ElvisNaci/>

<https://www.facebook.com/joneemrintim/>

<https://www.facebook.com/joneemrintim/>

<https://www.foltash.com/e-kujt-i-sherbeu-i-vetequajturi-kalife-bagdadi/>

<https://www.pri.org/stories/2017-10-03/there-s-no-evidence-linking-las-vegas-attack-isis-so-why-did-group-claim>, 2017

<https://www.ris.uu.nl/ws/files/20779691/2.full.pdf>

Aktakuza PPS nr. 25/2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, 7 maj 2015

Aktakuza PPS nr. 25/2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, 7 maj 2015

Aktakuza PPS nr. 111/2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, 7 maj 2015

Aktakuza PPS nr. 111/2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, 7 maj 2015

Intervistë me imamin lokal, janar 2019

Jakupi dhe Kelmendit, ‘Gratë në Ekstremizëm të Dhunshëm: Rasti i Kosovës’, QKSS 2017

- Jakupi.R. dhe Garentina Kraja “Shpjegimi i dallimit: Cenueshmëria dhe Reziliencia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm në Kosovë”, tetor 2018 http://www.qkss.org/repository/docs/CTR_CaseStudy3_kosovo_ENG_574166.pdf
- Kelmendi V., ‘Jo thjesht viktima: Gratë në Terrorizëm nga Ballkani Perëndimor’, f. 5, George Washington University 2019 https://extremism.gwu.edu/sites/g/files/zaxdzs2191/f/Perspectives%20on%20the%20Future%20of%20Women%2C%20Gender%20and%20Violent%20Extremism.pdf?fbclid=IwAR29VYWw42qTxV8v1S1iXdPgaCGWuUvVIF3_7DLnh7Tww8tN-33NwT79xtw
- Kraja.G ‘Dekonstruktimi i narrativës së ISIS-it në Kosovë’, QKSS, 2017. http://www.qkss.org/repository/docs/ISNinKosovo-eng_794656.pdf
- Nimer. M. Qasja alternative për transformimin e ekstremizmit të dhunshëm, Fondacioni Berghof, 2018 f. 8 https://www.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Handbook/Dialogue_Chapters/dialogue13_Abu-Nimer_lead.pdf
- Pattwell.A. dhe Tyson.M et al. ‘Terrorizmi si komunikim politik i dështuar’, Gazeta Ndërkombëtare e Komunikimit, 2015. <https://ijoc.org/index.php/ijoc/article/viewFile/2247/1359>
- Perteshi. S. “Raporti i Udhëzuesit të Gazetarëve”, QKSS, 2018 http://www.qkss.org/repository/docs/Guideline_669605_187367.pdf
- Rachel Briggs dhe Sebastian Feve, “Shqyrtimi i programeve të kundërveprimit ndaj narrativave të ekstremizmit të dhunshëm: Çka funksionon dhe cilat janë implikimet për qeverinë?” Instituti për Dialog Strategjik, (2013): 1, <https://www.counterextremism.org/resources/details/id/444/review-of-programs-to-counter-narratives-of-violentextremism-what-works-and-what-are-the-implications-for-government>
- Shpend Kursani, Raporti për Kundër-Narrativat, i pabotuar
- Strategjia Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm që Çon në Terrorizëm, Qeveria e Kosovës, 2016 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf
- Nuk ka prova që e lidhin sulmin e Las Vegasit me ISIS-in. Pse e mori përgjegjësinë ky grup?**
- Tuck. H. ‘Doracaku i kundër-narrativës’ 2016 https://www.isdglobal.org/wp-content/uploads/2016/06/Counter-narrative-Handbook_1.pdf f.65
- Zelin 2015
- Zieger. S. ‘Minimi i narrativave ekstremiste në Afrikën Lindore - Udhëzues praktik’, Hedayah, 2018.
- Ziger. S. ‘Minimi i narrativave ekstremiste në Afrikën Lindore - Udhëzues praktik’, Hedayah, 2018. f. 20 <http://www.hedayahcenter.org/Admin/Content/File-18201819229.pdf>

SHTOJCA A:

FJALË KYÇE:

Fjalë kyç	Fjalë kyç me thonjëza	Përkthimi
al furqan media	"al furqan media"	[Daesh media outlet]
al khansa brigade	"al khansa brigade"	[Female brigade of Daesh]
Amaq Agency	"Amaq Agency"	[Daesh media outlet]
amaq agency english	"amaq agency english"	[Daesh media outlet]
Amaq Agency news	"Amaq Agency news"	[Daesh media outlet]
Amaq Agency Twitter	"Amaq Agency Twitter"	[Daesh media outlet]
amaq news agency	"amaq news agency"	[Daesh media outlet]
anti ISIS coalition	"anti ISIS coalition"	
Bota Muslimane	"Bota Muslimane"	The Islamic World [name of Facebook page]
Coalition against Daesh	"Coalition against Daesh"	
coalition against ISIS country list	"coalition against ISIS country list"	
counter daesh nationen	"counter daesh nationen"	Nations against Daesh
counter daesh patch	"counter daesh patch"	
Dabiq	"Dabiq"	[Daesh propaganda magazine]
Dawla Islamiya Iraq	"Dawla Islamiya Iraq"	Islamic State Iraq
ebu bekr el bagdadi	"ebu bekr el bagdadi"	Abu Bakr al Baghdadi [Leader of Daesh]
Furat Media	"Furat Media"	[Daesh media outlet]
hayat media	"hayat media"	[Daesh media outlet]
Hilafeti	"Hilafeti"	The Caliphate
Hilafeti shqip	"Hilafeti shqip"	Caliphate in Albanian
honor is in jihad	"honor is in jihad"	[title of video released by Daesh]
How to join ISIS	"How to join ISIS"	
Islamic State nasheed	"Islamic State nasheed"	Islamic State acapella song
Islamic State website	"Islamic State website"	
Islamic State Wiki	"Islamic State Wiki"	
Islamic State Wordpress	"Islamic State Wordpress"	
Islamic State.Wordpress	"Islamic State.Wordpress"	
khilafah daulah islamiyah	"khilafah daulah islamiyah"	Caliphate Islamic State

kunder-#Isis	"kunder-#Isis"	anti-#ISIS
lajme isis	"lajme isis"	News of the Islamic State
Lavdrim Muhaxheri	"Lavdrim Muhaxheri"	[Kosovar Daesh leader and recruiter]
Lufta Isis	"Lufta Isis"	Battles ISIS
lufta ne irak	"lufta ne irak"	War in Iraq
Lufta ne Siri	"Lufta ne Siri"	War in Syria
"lufta ne siri alepo"	"lufta ne siri alepo"	War in Syria Aleppo
Rexhep Memishi	"Rexhep Memishi"	[Macedonian radical Imam]
Ridvan Haqifi	"Ridvan Haqifi"	[Kosovar Daesh commander]
Rumiyah	"Rumiyah"	[Daesh propaganda magazine]
rumiyah magazine	"rumiyah magazine"	[Daesh propaganda magazine]
rumiyah pdf	"rumiyah pdf"	[Daesh propaganda magazine]
shahid per allah	"shahid per allah"	Martyrs for Allah
shteti islamik	"shteti islamik"	Islamic State
shteti islamik i irakut dhe shamit	"shteti islamik i irakut dhe shamit"	Islamic State in Iraq and al Sham
shtetit islamik	"shtetit islamik"	Islamic State
Udhezimi Islam	"Udhezimi Islam"	Islamic Instruction [name of pro-Daesh website]
War against Daesh	"War against Daesh"	
war Islamic State	"war Islamic State"	
Wllayat al-Furat	"Wllayat al-Furat"	[Daesh province/media office in Iraq]
Wilayat al-Janub	"Wilayat al-Janub"	[Daesh province/media office in Iraq]
Wilayat al-Khayr	"Wilayat al-Khayr"	[Daesh province/media office in Syria]
xhahadi ne islam	"xhahadi ne islam"	Jihad in Islam
xhahadistet	"xhahadistet"	Jihadists
Zekerija Qazimi	"Zekerija Qazimi"	[Kosovar radical Imam]

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

316.74:2(=18)

2-673.5(=18)

Kelmendi, Vesë

Countering the myths of IS : how to counter the IS narrative online? : the case of Albanian-speaking countries / Vesë Kelmendi, Rudinë Jakupi. – Prishtinë : KCSS, 2019. – 40 f. ; 21 cm.

1.Jakupi, Rudinë

ISBN 978-9951-679-90-9

www.qkss.org

ISBN 978-9951-679-90-9



9 789951 679909